

VENDIM
Nr. 260, datë 25.3.2015

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES DHE VOLUMIT, TË EKONOMISË PYJORE “DHËMBEL-KALA”, NË OBJEKTIN “ARGOVA”, TË RRETHIT PËRMET, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “FLU-TO-NE” SHPK PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT RANOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 10 ha, në objektin “Argova”, pjesë e ngastrave 53a e 54a, të ekonomisë pyjore “Dhëmbel-Kala”, që do të përdoret nga shoqëria “FLU-TO-NE” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit ranor pllakor, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullësor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për ngastrat pyjore, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes, objekt mineral, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të sipërfaqes dhe volumit të lëndës drusore të paguhen nga shoqëria “FLU-TO-NE” sh.p.k., sipas tarifave të miratuara me vendimin nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “FLU-TO-NE” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim, sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 2 (dy) viteve të para, të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 10 ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “FLU-TO-NE” sh.p.k., të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin dhe realizimin e projekteve teknike, sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore, të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore/kullësore” dhe ta regjistrojë atë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet mineral”.


7. Me përmbushjen e detyrimeve, të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “FLU-TO-NE” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullësor publik.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria “FLU-TO-NE” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**HARTA TOPOGRAFIKE ME PARCELAT E PYJORES
E LEJES MINERARE TE SHFRYTEZIMIT Nr. 1710, Dt. 29/05/2014
OBJEKTI: "ARGOVE", KELCYRE, PERMET
SHKALLA 1:10 000**



**LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA
FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA "FLU-TO-NE" sh.p.k. në qarkun e GJIROKASTRES**

QARKU Gjirokaster

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Perdorimi territorit</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
GJ 31 53	Dhembel-Kala	53 a	cungishte	Ministria Mjedisit	4.54
GJ 31 54	Dhembel-Kala	54a	shkurre	Ministria Mjedisit	5.46
GJITHSEJ					10.00